



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.264/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

**Ankimues:**

“Rej” SHPK  
Lagjja 3 “Shëtitore Europa” Pogradec

**Autoriteti kontraktor:**

Bashkia e Tiranës  
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001

**Subjekt i Interesuar:**

Korsel” SHPK  
Rruga e “Durrësit”, Pallati 144/1 Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.12.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “*Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II*”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 25.01.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- Pastrime Silvio	pa ofertë	I skualifikuar
- Kevin Construction	pa ofertë	I skualifikuar
- Rej	482,102,488.50	I skualifikuar
- Korsel	540,249,464.85	I kualifikuar
- Fusha	543,314,238.75	I kualifikuar

II.4. Në datën 03.02.2021 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Shoqëria “Rej” SHPK ka deklaruar si shërbim i ngjashme kontratën me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit” me vlerë 62,669,376 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk është paraqitur Vërtetimi nga fushë depozitimi mbi depozitim për periudhën e kërkuar sipas DST (Janar 2018 - Janar 2021), por është paraqitur Vërtetimi për periudhën 17 Janar 2015 – 30 Nëntor 2018. • Pra referuar shumatores së vlerave të kontratave të paraqitura nga shoqëria “Rej” SHPK nuk plotësojnë DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti II, Kapaciteti Teknik, pika 1, ku shërbimet e së njëjtës natyrë duhet të jenë në vlerën 219,477,926 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- *Gjithashtu Shoqëria “Rej” ka siguruar ofertën për një periudhë kohore të ndryshme nga periudha e kërkuar sipas DST, çka bie në kundërshtim me DST, Njoftimi i Kontratës, Seksioni 4, pika 4.5.*

II.5. Në datën 10.02.2021 operatori ekonomik “Rej” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor ku përveç kundërshtimeve lidhur me arsyet e veta të skualifikimit kundërshton gjithashtu edhe kualifikimin e operatorit tjetër pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi “Korsel” SHPK ndër të tjera me pretendimet si më poshtë:

- *Në lidhje me arsyen e skualifikimit se shoqëria jonë ka siguruar ofertën në një kohë më të shkurtër se ajo e përcaktuar në DT sqarojmë se: Në nenin 14 të vendimit 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet se: Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën pesë ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti kontraktor do të refuzojë ofertën.*

*Sa më sipër theksojmë faktin se është detyrim i autoritetit kontraktor që në përfundim të periudhës së sigurimit të ofertës të kërkojë nga ofertuesit zgjatjen e periudhës së sigurimit të ofertës dhe vetëm në rast se këto të fundit refuzojnë atëherë KVO i lind e drejta e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik.*

*Gjithashtu sqarojmë se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lapsus kalemi dhe jo me një mospërmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor. Megjithatë nënvizojmë se për arsye teknike të pavarura nga ne si ankimues për shkak të problematikës së SPE nuk është bërë e mundur që të ngarkohet në SPE sigurimi i ofertës i cili përbën kohëzgjatjen e plotë të kërkuar prej 200 ditësh në dokumentet e tenderit.*

*Në botimet e Sigma-OECD Vendime Gjyqësore të përzgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë së BE për prokurimin publik (2006-2014) lexojmë se në çështjen C-336/12 Manova GJD arriti në përfundimin se autoriteti kontraktues mund të kërkonte ndreqjen ose amplifikimin e detajeve të aplikimit mbështetur në një arsye të kufizuar dhe të veçantë. Ky amendament lejohet për aq kohë sa kërkesa ka të bëjë me detaje ose informacione që tregojnë objektivisht se i përkasin periudhës para datës së skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve (paragrafi 39). GjD gjithashtu theksoi një kusht thelbësor: kërkesa për informacionin që mungon nuk duhet të favorizojë padrejtësisht apo ti krijojë disavantazhe kandidatit në fjalë. GjD i zbatoi këto kushte ndaj fakteve në çështjen C-336/12 Manova. Ajo konfirmoi se bilancet ekzistonin tashmë dhe ishin publikuar para paraqitjes së aplikimit. Ajo arriti në përfundimin se me pranimin e kopjeve të bilanceve pas datës së aplikimit autoriteti kontraktues nuk kishte shkelur parimin e trajtimit të barabartë.*

*Në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, neni 70 i*

së cilës parashikon se Palët njohin rëndësinë e përafrit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet, duke ju referuar vendimmarrjes së GJED (ashtu siç KPP në mënyrë të konsoliduar i referohet duke nisur nga viti 2014-shih vendimin KPP 613/2014) i referohet jurisprudencës së GJD së BE në vendimmarrjen e tij.

Pra me pranimin e sigurimit të ofertës pas datës së aplikimit autoriteti kontraktues nuk shkel parimin e trajtimit të barabartë pasi akti (sigurimi i ofertës) në përmbajtjen e tij të plotë vërtetuar edhe nga data e printimit të sistemit të shoqërive të sigurimit sistem i sigurt i cili ndërvepron aktivisht me sisteme shtetërore, me të njëjtin numër serial nuk shkel parimin e trajtimit të barabartë pasi mbi të gjitha ky fakt ka ndodhur për shkak të problemeve të pavarura nga shoqëria jonë.

- Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit Shoqëria “Rej” SHPK ka deklaruar si shërbim i ngjashme kontratën me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit” me vlerë 62,669,376 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk është paraqitur Vërtetimi nga fushë depozitimi mbi depozitimin për periudhën e kërkuar sipas DST (Janar 2018 - Janar 2021), por është paraqitur Vërtetimi për periudhën 17 Janar 2015 – 30 Nëntor 2018. Pra referuar shumatores së vlerave të kontratave të paraqitura nga shoqëria “Rej” SHPK nuk plotësojnë DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti II, Kapaciteti Teknik, pika I, ku shërbimet e së njëjtës natyrë duhet të jenë në vlerën 219,477,926 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në përmbushje të kriterit për punë të ngjashme nga ana e shoqërisë sonë është dorëzuar:

1. Pastrim grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të pogradecit me vlerë 64,982,596
2. Vazhdimi i shërbimit të pastrim grumbullimit dhe largimit të mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara shkurt 2020-korrik 2020 , me vlerë 46,930,061.34.
3. Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të pogradecit dhe njësive administrative Gusht 2020-Dhjetor 2020, 47,338,860
4. Pastrimi, grumbullimi dhe transportim të mbeturinave në teritorin administrativ të Bashkisë Prenjas 5 vjecar, Janar 2020-Dhjetor 2020 , 9,984,581
5. Shërbimi i pastrimit të njësive administrative Qendër, Novoselë, Shushicë të Bashkisë Vlorë Gusht-Dhjetor 2020 , 10,233,665
6. Grumbullimin, transportim mbetjesh urbane në vendet e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë Rej Energy Janar 2020-Janar 2021, 41,000,000  
Vlera totale pa TVSH 220,369,763.

*Sa më sipër arsyetuar lehtësisht konstataohet se nga ana e shoqërisë tonë është përmbushur dëshmia e eksperiencës së ngjashme në përputhje me dokumentet e procedurës së prokurimit. Kërkesa e autoritetit kontraktor është një kërkesë ekstra, megjithatë edhe kjo është përmbushur nga ana e shoqërisë sonë. Nënvizojmë se në asnjë rast nuk është parashikuar ashtu sikundër pretendohet se Vërtetimi nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve duhet të përfshijë informacion mbi tre vitet e fundit por është kërkuar shërbim i së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Ndaj ndodhemi para një kriteri të pakërkuar që bazuar në nenin 55 pika 2 të LPP nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk përfshihet në dokumentet e tenderit.*

*Së dyti vërtetimi nga fushë depozitimi i mbetjeve lëshohet vetëm për një nga zërat e kryerjes së shërbimit, grumbullim, transportim i mbetjeve urbane, ndërkohë që kontrata e ngjashme vlerësohet jo vetëm nga këto zëra por edhe nga zërat e tjerë si fshirje e rrugëve me krahë, fshirje e rrugëve me mjet teknologjik, lagje e rrugëve, largime vegjetacioni, grumbullim mbetjesh urbane (pa përfshirë transportimin). Gjithashtu sqarojmë se në kontratat e tjera shoqëria jonë shfaqet në cilësinë e BOE ku ka qenë përgjegjësi e anëtarëve të tjerë sipas ndarjes në kontratë dhe ndarjes së brendshme të organizimit të punës të depozitimit të mbetjeve në landfill si rrjedhojë ne skemi të drejtë që të marrim vërtetim.*

*Sa më sipër nënvizojmë se shoqëria jonë ka përmbushur më së miri kriterin e mësipërm dhe pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.*

- *Gjithashtu me keqardhje vëmë re se megjithëse shoqëria jonë është e vetmja që disponon të gjitha mjetet e kërkuara, ashtu siç kërkohet në dokumentet e tenderit, me një investim serioz dhe dinjitoz për kryerjen e shërbimit në kryeqytet shohim që autoriteti kontraktor pa të drejtë dhe në kundërshtim me ligjin ka kualifikuar operatorin Korsel SHPK i cili është kualifikuar si në lotin në të cilin ne kemi marrë pjesë ashtu edhe në lotin IV dhe Lotin II.*
  1. *Konkretisht operatori ekonomik Korsel SHPK nga verifikimet e kryera në Buletinin e Njoftimeve Publike nuk rezulton të përmbushë kriterin mbi dëshminë e eksperiencës së ngjashme sa 40% e fondit limit të 2 loteve të lotit 2 dhe 4 pra thënë ndryshe sa 582,179,972 lekë pa TVSH.*
  2. *Gjithashtu nga verifikimi i bilanceve të shoqërisë në QKB rezulton se kjo e fundit nuk përmbush kriterin në mënyrë kumulative për lotet që ka marrë pjesë në lidhje me kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë tre viteve të fundit ushtrimore lëshuar nga autoriteti përkatës , vlera mesatare e së cilës duhet të jetë më e vogël se 40% e fondit limit pra sa 582,179,972 lekë. Konkretisht në vitin 2020 shoqëria ka deklaruar të ardhura sa 382,909,989 ndërsa në vitin 2019 sa 348,663,142 lekë.*
  3. *Së treti shoqëria nuk disponon dëshmi të fuqisë punëtore sa 500 të punësuar si shumë kumulative e të dy loteve ku kjo shoqëri ka marrë pjesë.*

4. *Më e rëndësishmja nga të gjitha kjo shoqëri nuk plotëson kapacitetin teknik në drejtim të dëshmisë së mjeteve në mënyrë kumulative për të dy lotet dhe konkretisht për aq sa është kërkuar në lotin 2.*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve ku të përcaktohen targa e mjetit dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme.*

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **8 (tetë) copë**;*
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **2 (dy) copë**;*
- c) Makinë transportuese të kontejnerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontejnerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;*
- d) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;*
- e) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;*
- f) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Evropian.*

1. *Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*

- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*Dhe në lotin 4 ka vendosur kriterin*

*Ndaj sa më sipër gjykojmë se ky operator jo vetëm që nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit por ka dorëzuar edhe deklaratë të rreme mbi përmbushjen e kapaciteteve teknike për procedurat e prokurimit ku ky i fundit ka marrë pjesë.*

II.6. Në datën 15.02.2021 me shkresën nr.6689/4 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor

II.7. Në datën 24.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku përveç pretendimeve më sipër ankimuesi ka parashtruar argumentet si më poshtë:

- *Shkelja më e rëndë e kësaj procedure është fakti se shoqëria Korsel ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi ose të falsifikuara.*
- *Bazuar në dyshime të arsyeshme dhe informacionin që ne disponojmë shoqëria Korsel SHPK në përmbushje të kapaciteteve teknike në drejtim të disponueshmërisë së mjeteve krahas mjeteve të veta ka dorëzuar edhe mjete të marra me qira në Rumani.*
- *Konkretisht:*

- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË DEKLARUARA NË PROCEDURË NGA SHOQËRIA KORSEL SHPK	- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TREGËTAR RUMUN
- Targa TL29JTG - Nr. Shasi ZCFCD70A405164626	- Targa TL 29JTG - Nr. Shasi ZCFCD35A405164626
- Targa TL31JTG - Nr. Shasi ZCFC470B105218439	- Targa TL31JTG - Nr. Shasi ZCFC435B105218439
- Targa TL32JTG - Nr. Shasi ZCFC470B805218437	- Targa TL32JTG - Nr. Shasi ZCFC435B805218437

*Pra siç vihet re shumë lehtësisht për mjetet me targa TL29JTG, TL31JTG, TL 32JTG shoqëria Korsel ka falsifikuar të dhënat pasi ato nuk janë të njëjtat me të dhënat e deklaruara në regjistrin tregtar rumun siç vërtetohet edhe nga dokumentacioni i siguruar nga shoqëria jonë (bashkëngjitur kësaj shkrese). Akti konkret është tepër i rëndë pasi shoqëria ka paraqitur të dhëna të rreme si për certifikatën e regjistrimit (lejet e qarkullimit), tipin e mjetit, peshat matëse dhe për policën e sigurimit.*

*Mjetet e mësipërme janë dorëzuar për efekt të përmbushjes së kriterëve të kualifikimit:*



*d) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;*

*f) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Evropian.*

*Për të përmbushur kriterin për Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**; ka paraqitur këto targa dhe nr. shasie tip dhe pesha si më poshtë:*

*1.Mjeti TL29JTG me nr. shasie ZCFCD70A405164626, Tip Nr.IS70C12AAEPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.*

*Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë të regjistruar në rumani rezulton se:*

*Për mjetin me targë TL29JTG Nr. i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel SHPK ZCFCD35A405164626 Tip nr.IS35C12AA EPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2750 kg.*

*Polica e sigurimit të mjetit me targë TL29JTG dhe nr. Shasie ZCFCD70A405164626 nuk ekziston ndërsa Polica me targë TL29JTG dhe Nr. shasie ZCFCD35A405164626 ekziston.*

*2.Mjeti TL31JTG dhe nr. shasie ZCFC47B105218439, Tip IS70C12AA EPCP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.*

*Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezulton se:*

*Për mjetin me targë TL31JTG , nr. shasise është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel SHPK ZCFC435B105218439 Tip IS70C12AAEPCP 20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.*

*Polica e sigurimit të mjetit me targë TL31JTG dhe nr shasie ZCFC470B105218439 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL31JTG dhe Nr. Shasie ZCFC435B105218439 ekziston.*

*3.Mjeti TL32JTG dhe nr. shasie ZCFC470B805218437. Tip IS70CIIAA EPCP20-04 dhe peshë maksimale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3640 kg.*

*Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezultoi se:*

*Për mjetin me targë TL32JTG , numri i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel ZCFC435B805218437, Tip IS35CI2AA EPCP20-04 dhe peshë maksimale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.*

*Polica e sigurimit të mjetit me TL32JTG dhe nr. shasie ZCFC470B805218437 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL32JTG dhe nr. shasie ZCFC435B805218437 ekziston.*

- *Për të përmbushur kriterin Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Evropian.*

*Ka paraqitur këtë targë dhe nr. shasie dhe policë sigurimi të vlefshme si më poshtë:*

*TL04KZY Nr. Shasie VF630N166JD001587 dhe Policë sigurimi të vlefshme.*

*Por nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezultoi se mjeti autobot uji i paraqitur me targë TL04KZY dhe nr. shasie VF 630N166JD001587 në sistemin e siguracioneve të automjeteve në shtetin rumun nuk ekziston asnjë policë sigurimi e vlefshme.*

*Polica e sigurimit e paraqitur nga Korsel SHPK për këtë mjet ka të dhëna të pasakta dhe është dokument i falsifikuar.*

- *Theksojmë se është detyrim ligjor që në çdo moment autoriteti kontraktor para lidhjes së kontratës mund të përjashtojë një operator ekonomik që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi siç thuhet edhe në nenin 47 të ligjit për prokurimin publik. Kjo nuk është hera e parë që kjo shoqëri falsifikon letra për pjesëmarrje në procedura të prokurimit publik pasi edhe në raste të tjera konkretisht ka shfaqur të njëjtat problematika.*
- *Sa më sipër gjykojmë se ky operator ka dorëzuar deklaratë të rreme mbi përmbushjen e kapaciteteve teknike për procedurat e prokurimit ku ky i fundit ka marrë pjesë.*

- *Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë dhe skualifikimin e operatorit ekonomik Korsel SHPK.*
- *Përjashtimin e shoqërisë Korsel në përputhje me nenin 13 dhe 47 të LPP*

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.9564/1 prot datë 03.03.2021 protokolluar me tonën me nr.332/2 prot datë 04.03.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën nr.26 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.332/3 prot datë 05.03.2021, me lëndë “*Dokumente dhe fakte shtesë lidhur me falsifikimet e kryera nga shoqëria Korsel SHPK në procedurën e prokurimit “Shërbim i pastrimit të Tirana II”* operatorit ekonomik ka paraqitur shkresën nr.116-02.03.2021 datë 02.03.2021 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve”. Në shkresën e mësipërme, jepet informacion mbi të dhënat e mjeteve me targë TL 29 JTG, TL31JTG, TL32JTG, të deklaruara në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK.

II.10. Me shkresën Nr.332/5 prot datë 25.03.2021 me lëndë “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme verifikimin e origjinalitetit/autenticitetin e shkresës nr.116-02.03.2021 datë 02.03.2021 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve”. Në shkresën e mësipërme, jepet informacion mbi të dhënat e mjeteve me targë TL 29 JTG, TL31JTG, TL32JTG, të deklaruara në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK. Verifikimi është kërkuar të kryhet nëpërmjet shërbimit konsullor.

II.11. Me shkresën nr. 3791/1 prot datë 02.02.2021 me lëndë “*Konfirmim i palës rumune për vlefshmërinë e dokumentit bashkëngjitur*”, protokolluar me tonën me nr. 332/8 datë 22.04.2021 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sqaron si vijon: *Në vijim tuajës nr.332/5 datë 25.03.2021 bashkëngjitur konfirmimi i prefekturës së Tulceas në Rumani , dërguar ambasadës sonë në Bukuresht, për vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar , më datë 02.03.2021 nga Shërbimi Publik Komunitar për lejet e drejtimit dhe regjistrimit të automjeteve pranë Prefekturës së Tulceas në Rumani në emër të shtetasit rumun Santis Cosmin George.*

II.12. Referuar pretendimeve me shkrim të operatorit ekonomik “Rej” SHPK rezulton se, pretendimet për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Korsel” SHPK, lidhen me elemente të dokumentacionit të pretenduar të rreme për qëllime kualifikimi.

II.13. Për këtë arsye me vendimin Nr. 332/6 prot datë 25.03.2021 me objekt “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK me nr.332 datë 24.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

*1. Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK me nr.332 prot datë 24.02.2021, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.*

*2. T’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme.*

*3. Të dërgojë, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, kopje të materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr.332 Protokolli datë 24.02.2021.*

II.14. Me shkresën nr. 2157/1 prot datë 07.04.2021, me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr.332/7 datë 09.04.2021 Agjencia e Prokurimit Publik në mënyrë të përmbledhur sqaron se:

- *Lidhur me vendimmarrjen tuaj për pezullimin e shqyrtimit të ankesës së paraqitur deri në përfundimin e hetimit administrativ të APP për përjashtimin e operatorit ekonomik në fjalë nga pjesëmarrja në prokurimet publike sikurse jemi shprehur edhe më parë në lidhje me çështje të kësaj natyre ju sqarojmë se: KPP është organi më i lartë vendimmarrës për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimit publik, vendimet e të cilit kanë të bëjnë me kualifikimin /skualifikimin e ofertuesve në një procedurë të kontestuar prokurimi e për rrjedhojë gjithë ecurinë e kësaj procedure. Në këtë kontekst ligjvënësi ka parashikuar edhe afate kohore brenda të cilave KPP duhet të shprehet me vendim, në funksion të finalizimit në kohë të një procesi prokurimi synimi i të cilit është plotësimi i nevojave konkrete të autoriteteve kontraktore për mallra/punë apo shërbime të caktuara. Në bazë të nenit 63 pika 9 të LPP me marrjen e ankesës me shkrim të ankimesit KPP përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementëve formalë të ankimit brenda 5 ditëve duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, KPP merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar. Pra bazuar në parashikimet e ligjit të posaçëm, KPP ka detyrimin të dalë me vendim brenda një afati të përcaktuar qartazi. Pezullimi i shqyrtimit të ankesave dhe delegimi për hetime administrative në institucione të tjera administrative, do të zvarrisë procesin e prokurimit publik dhe do të nxisë përdorimin e paligjshëm të procedurës së prokurimit ‘negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.*

*Gjithashtu referuar edhe parashikimeve të nenit 64/1 në kuadër të procedurës së rishikimit administrativ KPP ka të drejtën të kërkojë informacion apo të kërkojë të dhëna e shpjegime*

*nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin e saj administrativ, hetim i cili për shkaqet e cituara më sipër duhet të përfundojë me një vendim përfundimtar që trajton ankesën. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 13/3 të LPP vendimmarrja e APP konsiston në përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike për një periudhë të caktuar kohore. Pra kompetencat e APP dhe KPP janë të ndryshme dhe ekzekutohen në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra dhe ky është një nga qëllimet e LPP në këto nene të sigurojë pavarësinë institucionale.*

*Bazuar në sa më sipër, APP vlerëson se KPP duhet të vijojë me shqyrtimin e ankesës dhe nëse nga vendimmarrja përfundimtare e KPP do të gjykohet se plotësohen kushtet që parashikon neni 13/3/a i LPP, atëherë çështja së bashku me provat përkatëse, bazuar në nenin 82 pika 1 e ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, duhet ti referohen APP për të vepruar më pas sipas kompetencave ligjore.*

II.15. Me vendimin Nr. 332/9 datë 25.05.2021 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të përfundojë pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” me nr. 332 protokollit datë 24.02.2021 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.*
- 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomikë ankimues, ( *thema decidendum*) KPP sqaron se procedura e shqyrtimi administrativ të ankesës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik rregullohet nga ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si edhe lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në përputhje me nenin 134 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik referuar pretendimeve me shkrim të operatorit ekonomik “Rej” SHPK rezulton se, pretendimet për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të

Vlerësimi të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Korsel” SHPK, lidhen me elementë të dokumentacionit të pretenduar të rreme për qëllime kualifikimi.

III.1.1. Për këtë arsye me vendimin Nr. 332/6 prot datë 25.03.2021 me objekt “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK me nr.332 datë 24.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

*1.Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK me nr.332 prot datë 24.02.2021, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.*

*2.T’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme.*

*3.T’ë dërgojë, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, kopje të materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr.332 Protokollit datë 24.02.2021.*

III.1.2. Me shkresën nr. 2157/1 prot datë 07.04.2021, me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr.332/7 datë 09.04.2021 Agjencia e Prokurimit Publik në mënyrë të përmbledhur sqaron se:

- *Lidhur me vendimmarrjen tuaj për pezullimin e shqyrtimit të ankesës së paraqitur deri në përfundimin e hetimit administrativ të APP për përjashtimin e operatorit ekonomik në fjalë nga pjesëmarrja në prokurimet publike sikurse jemi shprehur edhe më parë në lidhje me çështje të kësaj natyre ju sqarojmë se: KPP është organi më i lartë vendimmarrës për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimit publik, vendimet e të cilit kanë të bëjnë me kualifikimin /skualifikimin e ofertuesve në një procedurë të kontestuar prokurimi e për rrjedhojë gjithë ecurinë e kësaj procedure. Në këtë kontekst ligjvënësi ka parashikuar edhe afate kohore brenda të cilave KPP duhet të shprehet me vendim, në funksion të finalizimit në kohë të një procesi prokurimi synimi i të cilit është plotësimi i nevojave konkrete të autoriteteve kontraktore për mallra/punë apo shërbime të caktuara. Në bazë të nenit 63 pika 9 të LPP me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit KPP përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementëve formalë të ankimit brenda 5 ditëve duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor KPP merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar. Pra bazuar në parashikimet e ligjit të posaçëm, KPP ka detyrimin të dalë me vendim brenda një afati të përcaktuar qartazi. Pezullimi i shqyrtimit të ankesave dhe delegimi për hetime administrative në institucione të tjera administrative, do të zvarrisë procesin e prokurimit publik dhe do të nxisë përdorimin e paligjshëm të procedurës së prokurimit ‘negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.*

*Gjithashtu referuar edhe parashikimeve të nenit 64/1 në kuadër të procedurës së rishikimit administrativ KPP ka të drejtën të kërkojë informacion apo të kërkojë të dhëna e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin e saj administrativ, hetim i cili për shkaqet e cituara më sipër duhet të përfundojë me një vendim përfundimtar që trajton ankesën. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 13/3 të LPP vendimmarrja e APP konsiston në përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike për një periudhë të caktuar kohore. Pra kompetencat e APP dhe KPP janë të ndryshme dhe ekzekutohen në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra dhe ky është një nga qëllimet e LPP në këto nene të sigurojë pavarësinë institucionale.*

*Bazuar në sa më sipër, APP vlerëson se KPP duhet të vijojë me shqyrtimin e ankesës dhe nëse nga vendimmarrja përfundimtare e KPP do të gjykohet se plotësohen kushtet që parashikon neni 13/3/a i LPP, atëherë çështja së bashku me provat përkatëse, bazuar në nenin 82 pika 1 e ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, duhet ti referohen APP për të vepruar më pas sipas kompetencave ligjore.*

III.1.3. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se në interpretim të *lex specialis*, autoritet kompetent për kryerjen e verifikimeve, hetimeve dhe më pas marrjen e masave të përjashtimit të operatorëve ekonomikë që kanë paraqitur dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi është e Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërkohë që verifikimi, referuar nenit 47 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” mund të kryhet edhe nga ana e autoritetit kontraktor. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar një diskrecion më të lartë të autoritetit kontraktor, për të kryer veprimet procedurale të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik edhe pas përfundimit të vlerësimit fillestar, nëse konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi. Nga ana tjetër, megjithëse dy procedura të veçanta dhe regjime të posaçme juridike, ai i shqyrtimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ai i shqyrtimit të dokumentacionit të pretenduar si të dorëzuar të rremë nga ana e operatorëve ekonomikë, Komisioni vlerëson se në kuadër të procedurës së prokurimit në tërësi janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ky fakt lidhet me vendimmarrjen të Komisionit të Prokurimit Publik, pasi në vlerësim të KPP për efekt të ekonomisë së shqyrtimit administrativ dhe integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, këto dy momente janë të lidhura, pasi një operator ekonomik, në rast se verifikohet me dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi nuk mund të vijojë as me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit dhe as të marrë pjesë në procedura në procedura prokurimi, nëse konstatohet nga institucioni përgjegjës (APP) që këto dokumente janë të rreme.

Ashtu si edhe, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se në momentin që pretendohet se në një procedurë prokurimi janë paraqitur dokumente të rreme nuk mund të investohet të gjykojë çështjen në themel por i lind e drejta ti kërkojë bashkëpunim institucioneve kompetente për të provuar ose jo pretendimet e operatorëve ekonomikë, kjo në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, një ndër parimet kryesore të shqyrtimit administrativ është ai i efikasitetit që përfshin njëherazi shpejtësinë në vendimmarrje, sa më pak kosto për organin publik dhe palët dhe mbi të

gjitha të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm. Kjo, merr një vlerë tjetër të posaçme në procedurat e prokurimit publik. Kështu, *lex specialis* i ka vendosur kufij ligjor Komisionit për tu shprehur, ndërkohë që Kodi i Procedurave Administrative rregullon institutin e hetimit duke vendosur po kështu edhe kufij maksimal të afateve kohore të institucioneve të tjera. Nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik është pretenduar se “*Bazuar në sa më sipër , APP vlerëson se KPP duhet të vijojë me shqyrtimin e ankesës dhe nëse nga vendimmarrja përfundimtare e KPP do të gjykohet se plotësohen kushtet që parashikon neni 13/3/a i LPP , atëherë çështja së bashku me provat përkatëse, bazuar në nenin 82 pika 1 e ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, duhet ti referohen APP për të vepruar më pas sipas kompetencave ligjore.*”

Në këto kushte në respekt, të parimeve mbi të cilat ngrihet shqyrtimi i një hetim administrativ në përgjithësi dhe ai në fushën e prokurimit publik në veçanti, duke qenë se nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik ka një qasje të ndryshme doktrimore në lidhje me hetimin dhe brenda kufijve të parashikuar në ligj, Komisioni nuk është informuar për nisjen e hetimit gjykon se duhet të vijojë më tej me shqyrtimin në themel të ankesës për procedurën e prokurimit objekt ankimi referuar fakteve dhe provave të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ. Në lidhje me legjitimitimin (*locus standi*) për vënien në lëvizje të Komisionit të Prokurimit Publik, KPP vlerëson se në nenin 63 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” Neni 63 i ligjit rregullon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të vënë në lëvizje (*locus standi*) autoritetin kontraktor dhe më pas Komisionin e Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesave në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kontekst, parë në interpretim literal dhe teologjik dhe sistematik, një operator ekonomik do gëzojë interes të ligjshëm për të kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor nëse ky i fundit është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Parë në dritën e Direktivës mbi Mjetet e rishikimit administrativ, KPP që një operator ekonomik të legjitimohet për të dorëzuar një ankesë në kuadër të procedurës së prokurimit duhet njëherazi të ketë interes për të fituar kontratën dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar.

Në nenin 45 pika 2 gërma “e” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se: “*Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë , në rastet kur: është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t’i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.*” Në rastin konkret, ligjvënësi ka parashikuar një pozitë të veçantë të trajtimit të rastit kur operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi, akoma më tej, kjo përcaktuar edhe në nenin 47 të ligjit për prokurimin publik ku parashikohet se : “*Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme , për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës . Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13*



*pika 3 të këtij ligji.*” Në këtë mënyrë të drejtës për të skualifikuar një operator ekonomik për paraqitjen e dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi i është dhënë një pozitë e veçantë juridike duke e shtrirë në çdo moment para lidhjes së kontratës, për vetë faktin se ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit janë ato të mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, ndërkohë që vetë ligji në tërësi ndër qëllimet kryesore ka atë të nxitjes së konkurrencës, por edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, të cilat cenohen në rast se një operator ekonomik paraqet në përmbushje të kriteve të veçanta të kualifikimit dokumentacion të rremë për qëllime

Për këtë qëllim, Komisioni vlerëson të ndalet në dy momente të veçanta në arsyetimin e vendimit, atë të pretendimeve të një operatori ekonomik për dorëzimin e dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi nga ana një operatori tjetër ekonomik si edhe atë të këtij të fundit, në lidhje me kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK me argumentet se *Shkelja më e rëndë e kësaj procedure është fakti se shoqëria Korsel ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi ose të falsifikuara. Bazuar në dyshime të arsyeshme dhe informacionin që ne disponojmë shoqëria Korsel SHPK në përmbushje të kapaciteteve teknike në drejtim të disponueshmërisë së mjeteve krahas mjeteve të vet aka dorëzuar edhe mjete të marra me qira në Rumani.*

- Konkretisht:

- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË DEKLARUARA NË PROCEDURË NGA SHOQËRIA KORSEL SHPK	- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TREGËTAR RUMUN
- Targa TL29JTG - Nr. Shasi ZCFCD70A405164626	- Targa TL 29JTG - Nr. Shasi ZCFCD35A405164626
- Targa TL31JTG - Nr. Shasi ZCFC470B105218439	- Targa TL31JTG - Nr. Shasi ZCFC435B105218439
- Targa TL32JTG - Nr. Shasi ZCFC470B805218437	- Targa TL32JTG - Nr. Shasi ZCFC435B805218437

*Pra siç vihet re shumë lehtësisht për mjetet me targa TL29JTG, TL31JTG, TL 32JTG shoqëria Korsel ka falsifikuar të dhënat pasi ato nuk janë të njëjtat me të dhënat e deklaruara në regjistrin tregtar rumun siç vërtetohet edhe nga dokumentacioni i siguruar nga shoqëria jonë (bashkëngjitur kësaj shkrese). Akti konkret është tepër i rëndë pasi shoqëria ka paraqitur të dhëna të rreme si për certifikatën e regjistrimit (lejet e qarkullimit), tipin e mjetit, peshat matëse dhe për policën e sigurimit. Për të përmbushur kriterin për Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.; me kapacitet transportues 3.5*

ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**; ka paraqitur këto targa dhe nr. shasje tip dhe pesha si më poshtë:

1.Mjeti TL29JTG me nr. shasje ZCFCD70A405164626, Tip Nr.IS70C12AAEPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë të regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL29JTG Nr. i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel SHPK ZCFCD35A405164626 Tip nr.IS35C12AA EPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2750 kg.

Polica e sigurimit të mjetit me targë TL29JTG dhe nr. Shasje ZCFCD70A405164626 nuk ekziston ndërsa Polica me targë TL29JTG dhe Nr. shasje ZCFCD35A405164626 ekziston.

2.Mjeti TL31JTG dhe nr. shasje ZCFC47B105218439, Tip IS70C12AA EPCP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL31JTG , nr. shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel SHPK ZCFC435B105218439 Tip IS70C12AAEPCP 20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.

Polica e sigurimit të mjetit me targë TL31JTG dhe nr. shasje ZCFC470B105218439 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL31JTG dhe Nr. Shasje ZCFC435B105218439 ekziston.

3.Mjeti TL32JTG dhe nr. shasje ZCFC470B805218437. Tip IS70C11AA EPCP20-04 dhe peshë maksimale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3640 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL32JTG , numri i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel ZCFC435B805218437, Tip IS35C12AA EPCP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.

*Polica e sigurimit të mjetit me TL32JTG dhe nr. shasie ZCFC470B805218437 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL32JTG dhe nr. shasie ZCFC435B805218437 ekziston.*

- *Për të përmbushur kriterin Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Evropian.*

*Ka paraqitur këtë targë dhe nr. shasie dhe policë sigurimi të vlefshme si më poshtë:*

*TL04KZY Nr. Shasie VF630N166JD001587 dhe Policë sigurimi të vlefshme.*

*Por nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezulton se mjete autobot uji i paraqitur me targë TL04KZY dhe nr. shasie VF 630N166JD001587 në sistemin e siguracioneve të automjeteve në shtetin rumun nuk ekziston asnjë policë sigurimi e vlefshme.*

*Polica e sigurimit e paraqitur nga Korsel SHPK për këtë mjet ka të dhëna të pasakta dhe është dokument i falsifikuar.*

- *Theksojmë se është detyrim ligjor që në çdo moment autoriteti kontraktor para lidhjes së kontratës mund të përjashtojë një operator ekonomik që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi siç thuhet edhe në nenin 47 të ligjit për prokurimin publik. Kjo nuk është hera e parë që kjo shoqëri falsifikon letra për pjesëmarrje në procedura të prokurimit publik pasi edhe në raste të tjera konkretisht ka shfaqur të njëjtat problematika.*
- *Sa më sipër gjykojmë se ky operator ka dorëzuar deklaratë të rreme mbi përmbushjen e kapaciteteve teknike për procedurat e prokurimit ku ky i fundit ka marrë pjesë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 8 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të targa e mjetit dhe sasi të përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **8 (tetë) copë**;*
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **2 (dy) copë**;*
- c) Makine transportuese të kontejnerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontejnerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;*

- d) *Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;*
- e) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**.*
- f) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.*

2. *Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- b) *Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të mjeteve të deklaruara në Shtojcën Nr. 7/2 si dhe te deklarojë adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve në Shqipëri, me qellim verifikimin e tyre. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet e deklaruara sipas Shtojcës 7/2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e skualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.*

III.2.2. Në shtojcën “Mbi Modifikimin Dhe Ndryshimin E Dokumenteve Standarde Të Tenderit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

***Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9:***

## ISHTE:

9. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
  - b. Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
  - c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
  - d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të mjeteve të deklaruara në Shtojcën Nr. 7/2 si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet e deklaruara sipas Shtojcës 7/2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e skualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

## BËHET

9. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
  - b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
  - c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
  - d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të mjeteve

*të deklaruar në Shtojcën Nr. 7/2 si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet e deklaruar sipas Shtojcës 7/2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e skualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.*

- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas Shtojcës 7/2 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.*

III.2.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik Korsel SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi disponimin e makinierive ku ndër të tjera janë deklaruar mjetet si më poshtë:

Në pronësi

- Makinë vetshkarkuese me targa AA928UH
- Autobot Uji me targa AA259TX

Me kontratë qiraje Nr.85 datë 19.01.2021-18.01.2025

- Makinë vetshkarkuese me targa TL-29JTG, me numër leje qarkullimi T00119792L, Nr. shasie ZCFCD70A405164626, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea, Licencë nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto,
- Makinë vetshkarkuese me targa TL-31JTG, me numër leje qarkullimi T00132640L, Nr. shasie ZCFC47B105218439, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea, 021999912, Licencë nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto,
- Makinë vetshkarkuese me targa TL-32-JTG, me numër leje qarkullimi T00122962L me numër shasie ZCFC470B805218437, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea 017255502, Licencë Nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto,
- Makinë vetshkarkuese me targa AA113ZG , me numër leje qarkullimi DRD1999, me numër shasie ĘDB9700151L353894
- Autobot Uji me targa TL-04-KZY, me numër leje qarkullimi T00122962L, me numër shasie VF630N166JD001587. Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea 021999910, Instalimi i fletës teknike të të dhënave për larjen e rrugëve të sperkatjes dhe larjen me presion të lartë të ujit të montuar në nënkornizën e grepit (Abroll), Licencë Nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën

*dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”

III.2.5. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *Licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) *c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) *ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar si dhe marrë shkas nga pretendimet e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik “Rej” SHPK mbi paraqitjen nga ana e operatorit ekonomik “Korsel” të dokumentacionit të rremë në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe provës së paraqitur nga ankimuesi me shkresën nr.26 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.332/3 prot datë 05.03.2021, me lëndë “*Dokumenta dhe fakte shtesë lidhur me falsifikimet e kryera nga shoqëria Korsel SHPK në procedurën e prokurimit “Shërbim i pastrimit të Tirana II”, Komisioni i Prokurimit Publik njëherazi me pezullimin e shqyrtimit administrativ të çështjes dhe dërgimin e akteve pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për hetim, për përshpejtim të procesit dhe lehtësi të hetimit me shkresën Nr.332/5 prot datë 25.03.2021 i është drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme duke kërkuar nga kjo e fundit verifikimin e origjinalitetit të provës së paraqitur nga operatori ekonomik Rej SHPK dhe administruar nga Komisioni në fashikullin e shqyrtimit administrativ, nëpërmjet shërbimit konsullor. Konkretisht është kërkuar verifikimi i shkresës nr.116-02.03.2021 datë 02.03.2021 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve”. Në shkresën e mësipërme, jepet informacion mbi të dhënat e mjeteve me targë TL 29 JTG, TL31JTG, TL32JTG, të deklaruara në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK.*

1. Konkretisht për mjetin me targa TL29JTG jepen të dhëna si vijon:

- Data e regjistrimit të parë 16.08.2017

- Marka Iveko
- Tipi IS35C12AA
- Varianti EPTP20-04
- Numri shasisë ZCFCD35A405164626
- Pesha maksimale teknike e pranuar 3500 kg
- Pesha gjatë ecjes 2750 kg

### 2.Për mjetin me targa TL31JTG

- Data e regjistrimit të parë 20.08.2018
- Marka Iveko
- Tipi IS35C12AA
- Varianti EPCP20-04
- Numri shasisë ZCFC435B105218439
- Pesha maksimale teknike e pranuar 3500 kg
- Pesha gjatë ecjes 2800 kg

### 3.Për mjetin me targa TL32JTG

- Data e regjistrimit të parë 20.08.2018
- Marka Iveko
- Tipi IS35C12AA
- Varianti EPCP20-04
- Numri shasisë ZCFC435B805218437
- Pesha maksimale teknike e pranuar 3500 kg
- Pesha gjatë ecjes 2800 kg

III.2.7. Me shkresën nr. 3791/1 prot datë 02.02.2021 me lëndë “Konfirmim i palës rumune për vlefshmërinë e dokumentit bashkëngjitur”, protokolluar me tonën me nr. 332/8 datë 22.04.2021 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sqaron si vijon: ***Në vijim tuajës nr.332/5 datë 25.03.2021 bashkëngjitur konfirmimi i prefekturës së Tulceas në Rumani , dërguar ambasadës sonë në Bukuresht, për vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar , më datë 02.03.2021 nga Shërbimi Publik Komunitar për lejet e drejtimit dhe regjistrimit të automjeteve pranë Prefekturës së Tulceas në Rumani në emër të shtetasit rumun Santis Cosmin George.***

III.2.8. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK në përmbushje të kriterit mbi disponimin e makinerive e në mënyrë specifike mbi mjetet vetëshkarkuese me kapacitet 3.5 ton, KPP konstaton se operatori ekonomik Korsel SHPK disponon me anë të kontratës së qerese makineritë si vijon: Makinë vetëshkarkuese me targa TL-29JTG, me numër leje qarkullimi T00119792L, Nr. shasie ZCFCD70A405164626, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea, Licencë nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto; Makinë vetëshkarkuese me targa TL-31JTG, me numër leje qarkullimi T00132640L, Nr. shasie ZCFC47B105218439, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea, 021999912, Licencë



nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto,; Makinë vetëshkarkuese me targa TL-32-JTG, me numër leje qarkullimi T00122962L me numër shasie ZCFC470B805218437, Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea 017255502, Licencë Nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto,; Makinë vetëshkarkuese me targa AA113ZG , me numër leje qarkullimi DRD1999, me numër shasie ĒDB9700151L353894I Autobot Uji me targa TL-04-KZY, me numër leje qarkullimi T00122962L, me numër shasie VF630N166JD001587. Certifikatë Regjistrimi komuniteti evropian Tulcea 021999910, Instalimi i fletës teknike të të dhënave për larjen e rrugëve të spërkatjes dhe larjen me presion të lartë të ujit të montuar në nënkornizën e grepit (Abroll), Licencë Nr.0173551 për JT Grup SRL, Foto.

Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin mbi mjetet të dorëzuar nga operatori ekonomik Korsel SHPK, KPP vëren se ekzistojnë mospërputhje me të dhënat që përmban prova e paraqitur nga operatori ekonomik Rej SHPK dhe për të cilën Ministria për Punët e Jashtme dhe Evropën vërtetoi autenticitetin e provës së dorëzuar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Konkretisht KPP vëren se ekzistojnë mospërputhje në numrin e shasisë së deklaruar për të treja mjetet si dhe në peshën maksimale të pranuar. Për të treja mjetet këto elemente rezultojnë të ndryshme në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori Korsel SHPK ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe provës së administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ nga KPP, dokument i lëshuar nga Regjistri Tregtar Rumun. Për të treja mjetet referuar shkresës 116-02.03.2021 datë 02.03.2021 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve pesha maksimale e pranuar rezulton të jetë 3500 kg. Ndërkohë në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik Korsel SHPK për mjetin me targa TL-29JTG deklarohet si peshë maksimale e pranuar 3680 kg, Për mjetin me targë TL-31JTG deklarohet pesha 3670 kg dhe për mjetin me targa TL-32JTG 3640 kg.

I njëjti konstatim vjen edhe sa i takon numrit të shasisë së mjeteve, kjo midis dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK dhe letër konfirmimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve, konfirmuar si autentike nga Ministria për Punët e Jashtme dhe Evropën. Konkretisht, konstatohet mospërputhja për mjetet

Mjeti me *targë TL29JTG* është deklaruar me numër *shasie: ZCFCD70A405164626* ndërkohë, referuar shkresës nr. \_\_\_\_\_ nr. Shasisë rezulton *ZCFCD35A405164626*

Mjeti me *targë TL31JTG* është deklaruar me numër *shasie: ZCFC470B105218439* ndërkohë, referuar shkresës nr. \_\_\_\_\_ nr. Shasisë rezulton *ZCFC435B105218439*

Mjeti me *targë TL32JTG* është deklaruar me numër *shasie ZCFC470B805218437* ndërkohë, referuar shkresës nr. \_\_\_\_\_ nr. Shasisë rezulton *ZCFC435B805218437*

III.2.9. Sa më sipër, KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, KPP gjykon se operatori ekonomik Korsel nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm lidhur me disponimin e makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës pasi ka mospërputhje midis të dhënave të deklaruara dhe atyre të konfirmuara nga organet e tjera të administratës shtetërore në regjistrat publikë të shtetit Rumun.

Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe se autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë operatorin ekonomik “Korsel” në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Rej SHPK” mbi skualifikimin e operatorit ekonomik Korsel SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *Shoqëria “Rej” SHPK ka deklaruar si shërbim i ngjashme kontratën me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit” me vlerë 62,669,376 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk është paraqitur Vërtetimi nga fushë depozitimi mbi depozitimin për periudhën e kërkuar sipas DST (Janar 2018 - Janar 2021), por është paraqitur Vërtetimi për periudhën 17 Janar 2015 – 30 Nëntor 2018. Pra referuar shumatores së vlerave të kontratave të paraqitura nga shoqëria “Rej” SHPK nuk plotësojnë DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti II, Kapaciteti Teknik, pika 1, ku shërbimet e së njëjtës natyrë duhet të jenë në vlerën 219,477,926 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH’, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën 8 pika 3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

*Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 223,874,426 (dyqind e njëzet e tre milion e tetëqind e*

shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjate tri viteve te fundit.

**1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e shërbimeve;
  - Kontratë Shërbimi;
  - Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;
  - Situacionet për shërbimet e kryera;
  - Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim realizim shërbimi ku të shënohet vlera, koha, objekti i shërbimit të kryer si dhe te përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes se shërbimit te realizuar ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik;
  - Kontrate Shërbimi;
  - Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;
  - Situacionet për shërbimet e kryera;
  - Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 përcaktohet se: “2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.3. Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e veçantë të vendosur.

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi përvojën e ngjashme e konkretisht dokumentit *Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve*, të kërkuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, KPP gjykon se ky kriter është i paqartë, pasi referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi preventivi i shërbimeve përmban nëntë elementë të ndryshëm, duke nisur nga dy zëra grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane sipas dy metodologjive të ndryshme, larja dhe dezinfektim i kontejnerëve, mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve, fshirja e rrugëve dhe trotuareve, fshirja e rrugëve me makineri, mirëmbajtja e rrugëve kryesore, larja e rrugëve sipas dy metodologjive të ndryshme. Ndërkohë, për përmbushjen me sukses të kontratës autoriteti kontraktor kërkon edhe vërtetim nga venddepozitimet e mbetjeve, të cilat përbëjnë vetëm një element të pjesshëm të vërtetimit të realizimit vetëm të dy nga nëntë zërat e shërbimit të kërkuar. KPP gjykon se kriteri i mësipërm ka sjellë gjithashtu paqartësi si në përmbushjen e tyre nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në drejtim të kohëzgjatjes së vërtetimit të mësipërm por edhe të vlerësimit nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, autoriteti kontraktor, qartazi ka vendosur në një pozitë të pabarabartë edhe vetë vërtetimin e ngjashmërisë së kontratës, kur për dy zëra kërkohej edhe dokumentacion shtesë dhe provues ( vërtetim lëshuar nga vend depozitimi i mbetjeve), ndërkohë që për 7 zëra të tjerë, të cilët kanë një peshë të konsiderueshme në kontratë është kërkuar vetëm vërtetim lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e tyre. Gjithashtu, me kërkesën e mësipërme, autoriteti kontraktor ka tejkalluar tërësisht kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këto kushte KPP gjykon se dokumenti *Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve* nuk përputhet me qëllimin e kriterit dhe e tejkallon atë pasi nuk është një dokument i cili nuk shërben për provimin e eksperiencës së ngjashme të operatorëve ekonomikë . KPP gjykon se kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit. Mospërcaktimi i saktë i kriterit të mësipërm, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, pasi përcaktimi i këtij kriteri si më sipër cituar, ka shkaktuar konfuzion dhe gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për komisionin e vlerësimit të ofertave. Kriteri lidhur me përvojën e ngjashme e parashikuar nga neni 28 pika 5 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar ka për qëllim të dëshmojë dhe provojë që operatorët ekonomikë janë të aftë të realizojnë kontratën objekt prokurimi pasi kanë kryer natyrë të ngjashme shërbimi /pune apo furnizimi duke i dhënë garancinë autoritetit kontraktor mbi realizimin me sukses në kohë dhe cilësinë e kërkuar. Dokumentacioni që duhet të kërkohej në drejtim të provueshmërisë së eksperiencës së ngjashme është tërësisht i qartë dhe nuk lë vend për zgjerim nga ana e autoritetit kontraktor. Kontrata e realizuar e shoqëruar me vërtetim realizimi në rastet kur shërbimi kryhet në favor të autoriteteve kontraktore apo fatura tatimore të shitjes në rastin kur shërbimi realizohet në favor të subjekteve private në të cilat përshkruhet datat, shumat dhe shërbimet e realizuara është mëse e mjaftueshme që autoriteti kontraktor të vlerësojë eksperiencën e ngjashme të operatorëve pjesëmarrës. Ndërkohë dokumenti *Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e*

*mbetjeve*, i kërkuar në rastin konkret, është diskriminues, i panevojshëm dhe shërben vetëm për shtimin e barrës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Në këtë kuptim, KPP gjykon se jemi në kushtet e hartimit nga ana e autoritetit kontraktor, të një kriteri kualifikimi në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, i cili ka krijuar paqartësi si në lidhje me përmbushjen e kontratës së ngjashme ashtu edhe në vlerësimin e tyre nga ana zyrtarëve të prokurimit. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit duhet të ketë parasysh element të tilla si mosdiskriminimi, proporcionaliteti, dobishmëria dhe nevoja si dhe qartësia në hartimin e tyre në mënyrë shmangien e çdo lloj paqartësie dhe konfuziteti për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata diskriminuese e krijuar nga moshartimi i kriterëve në përputhje me dispozitat ligjore, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nuk do të merren në shqyrtim në themel, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK lidhur me pretendimet për skualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Të mos marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Korsel” SHPK dhe më pas të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
  4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr.332 prot datë 24.02.2021.
  5. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.332 Protokoli; Datë 24.02.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

## Mendim Paralel

Ne anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, Vilma Zhupaj dhe Lindita Skeja jemi pjesërisht dakord me arsyetimin e vendimit në pikën III.1 e në vijim e rrjedhimisht edhe me dispozitivin e vendimit lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Rej shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-80606-12-01-2020 me objekt: Loti II: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”, me fond limit 548,694,815 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tij, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyetojmë

I.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” sh.p.k., mbi skualifikimin e operatorit ekonomik Korsel shpk me arsyetimin se “Shkelja më e rëndë e kësaj procedure është fakti se shoqëria Korsel ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi ose të fallsifikuara. Bazuar në dyshime të arsyeshme dhe informacionin që ne disponojmë shoqëria Korsel shpk në përmbushje të kapaciteteve teknike në drejtim të disponueshmërisë së mjeteve krahas mjeteve të vet aka dorëzuar edhe mjete të marra me qira në Rumani.

- Koncretisht:

- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË DEKLARUARA NË PROCEDURË NGA SHOQËRIA KORSEL SHPK	- MJETI RUMUM SIPAS TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TREGËTAR RUMUN
- Targa TL29JTG - Nr Shasi ZCFCD70A405164626	- Targa TL 29JTG - Nr Shasi ZCFCD35A405164626
- Targa TL31JTG - Nr Shasi ZCFC470B105218439	- Targa TL31JTG - Nr Shasi ZCFC435B105218439
- Targa TL32JTG - Nr Shasi ZCFC470B805218437	- Targa TL32JTG - Nr Shasi ZCFC435B805218437

Pra sic vihet re shumë lehtësisht për mjetet me targa TL29JTG, TL31JTG, TL 32JTG shoqëria Korsel ka falsifikuar të dhënat pasi ato nuk janë të njëjtat me të dhënat e deklaruara në regjistrin tregëtar rumun sic vërtetohet edhe nga dokumentacioni i siguruar nga shoqëria jonë (bashkëngjitur kësaj shkrese). Akti konkret është tepër i rëndë pasi shoqëria ka paraqitur të dhëna të rreme si për certifikatën e regjistrimit (lejet e qarkullimit), tipin e mjetit, peshat mjetëse dhe për policën e sigurimit. Për të përmbushur kriterin për Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbejeteve vëllimshme

dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**; ka paraqitur këto targa dhe nr shasie tip dhe pesha si më poshtë:

1.Mjeti TL29JTG me nr shasie ZCFCD70A405164626, Tip Nr.IS70C12AAEPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë të regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL29JTG Nr i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel shpk ZCFCD35A405164626 Tip nr.IS35C12AA EPTP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2750 kg.

Polica e sigurimit të mjetit me targë TL29JTG dhe nr. Shasie ZCFCD70A405164626 nuk ekziston ndërsa Polica me targë TL29JTG dhe Nr shasie ZCFCD35A405164626 ekziston.

2.Mjeti TL31JTG dhe nr shasie ZCF47B105218439, Tip IS70C12AA EPCP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3670 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL31JTG , nr shasise është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel shpk ZCF435B105218439 Tip IS70C12AAEPCP 20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.

Polica e sigurimit të mjetit me targë TL31JTG dhe nr shasie ZCF470B105218439 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL31JTG dhe Nr. Shasie ZCF435B105218439 ekziston.

3.Mjeti TL32JTG dhe nr shasie ZCF470B805218437. Tip IS70C11AA EPCP20-04 dhe peshë maksimale të autorizuar 7200 kg dhe peshë e mjetit bosh 3640 kg.

Por nga verifikimet e kryera nga ana jonë në faqet zyrtare të internetit të shtetit rumun për regjistrimin e mjeteve ku janë database të mjeteve që janë regjistruar në rumani rezulton se:

Për mjetin me targë TL32JTG , numri i shasisë është i ndryshëm nga ai që ka paraqitur Korsel ZCF435B805218437, Tip IS35C12AA EPCP20-04 dhe peshë maximale të autorizuar 3500 kg dhe peshë e mjetit bosh 2800 kg.

Polica e sigurimit të mjetit me TL32JTG dhe nr shasie ZCF470B805218437 nuk ekziston ndërsa polica me targë TL32JTG dhe nr shasie ZCF435B805218437 ekziston.

- Për të përmbushur kriterin Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

Ka paraqitur këtë targë dhe nr shasie dhe policë sigurimi të vlefshme si më poshtë:

TL04KZY Nr Shasie VF630N166JD001587 dhe Policë sigurimi të vlefshme.



*Por nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezultoi se mjete autobot uji i paraqitur me targë TL04KZY dhe nr shasie VF 630N166JD001587 në sistemin e siguracioneve të automjeteve në shtetin rumun nuk ekziston asnjë policë sigurimi e vlefshme.*

*Polica e sigurimit e paraqitur nga Korsel shpk për këtë mjet ka të dhëna të pasakta dhe është dokument i fallsifikuar.*

- *Theksojmë se është detyrim ligjor që në çdo moment autoriteti kontraktor para lidhjes së kontratës mund të përjashtojë një operator ekonomik që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi sic thuhet edhe në nenin 47 të ligjit për prokurimin publik. Kjo nuk është hera e parë që kjo shoqëri falsifikon letra për pjesmarrje në procedura të prokurimit publik pasi edhe në raste të tjera konkretisht ka shfaqur të njëjtat problematika.*

*Sa më sipër gjykojmë se ky operator ka dorëzuar deklaratë të rreme mbi përpmbushjen e kapaciteteve teknike për procedurat e prokurimit ku ky i fundit ka marrë pjesë, vërej se*

I.2. Me shkresën nr.26 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.332/3 prot datë 05.03.2021, me lëndë “*Dokumenta dhe fakte shtesë lidhur me falsifikimet e kryera nga shoqëria Korsel shpk në procedurën e prokurimit “Shërbim i pastrimit të Tirana II” operatori ekonomik ka paraqitur shkresën nr.116-02.03.2021 datë 02.03.2021 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Institucioni i Prefektit, Rrethi Tulcea/ Shërbimi Publik Komunitar i Lëshimit të Lejeve të Qarkullimit dhe i Regjistrimit të Automjeteve*”. Në shkresën e mësipërme, jepet informacion mbi të dhënat e mjeteve me targë TL 29 JTG, TL31JTG, TL32JTG, të deklaruara në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik “Korsel” shpk.

I.3. Në pikën III.4 e në vijim Komisioni i Prokurimit Publik ka arsyetuar se situata diskriminuese e krijuar nga moshartimi i kriterëve në përputhje me dispozitat ligjore, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi.

I.4. Referuar sa më sipër, gjykojmë se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Rej shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” shpk nuk duhet të merren në shqyrtim në themel nga Komisioni për shkak se procedura e prokurimit objekt ankimi sipas arsytimit të vendimit në pikën III.4 e në vijim do të anulohet e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin në kuptim të nenit 63 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar i cili parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” Neni 63 i ligjit rregullon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të vënë në lëvizje autoritetin kontraktor dhe më pas Komisionin e Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesave në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kontekst, parë në interpretim literal dhe teologjik dhe sistematik, një operator ekonomik do gëzojë interes të ligjshëm për të kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor nëse ky i fundit është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Gjykojmë se që një operator ekonomik të legjitimohet për të dorëzuar një ankesë në kuadër të procedurës së prokurimit duhet njëherazi të ketë interes për të fituar

kontratën ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret në kushtet kur procedura e prokurimit do të anulohet gjykojmë se Komisioni duhet të shprehej lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të pretendimeve të operatorit Rej shpk. Ndërsa sa i takon provës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” shpk konkretisht shkresës nr.26 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.332/3 prot datë 05.03.2021, me lëndë “*Dokumenta dhe fakte shtesë lidhur me falsifikimet e kryera nga shoqëria Korsel shpk në procedurën e prokurimit “Shërbim i pastrimit të Tirana II”*”, Komisioni duhet ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ lidhur me faktin sa më sipër, në përputhje me nenin 13 të LPP-së.

I.5. Sa më sipër arsyetuar, jemi pjesërisht dakord me arsyetimin në pikën III.1. e në vijm të vendimit të shumicës si dhe pjesërisht dakord me dispozitivin e vendimit. Konkretisht nuk jemi dakord me legjitimitimin e operatorit ekonomik “Rej” shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” shpk si dhe me pikën 1 të dispozitivit të vendimit i cili pranon ankesën e operatorit ekonomik “Rej” shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” shpk, për sa kohë që procedura e prokurimit objekt ankimi do të anulohet.

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**